



18 Maj 2007

Komunikata e Londrës

Në drejtim të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë: në përgjigje të sfidave në botën e globalizuar

1. Hyrje

1.1 Ne, ministrat përgjegjës për arsimin e lartë në vendet pjesëmarrëse të Procesit të Bolonjës, jemi takuar në Londër për të shqyrtuar përparimin e shënuar prej mbledhjes tonë të fundit në Bergen në vitin 2005

1.2 Duke u bazuar në kriteret tona për anëtarësimin e vendeve në Proces, i dëshirojmë mirëseardhje Republikës së Malit të Zi si anëtare e re e Procesit të Bolonjës.

1.3 Zhvillimet e dy viteve të fundit na kanë sjellur për një hap të madh më afër realizimit të Hapësirës Evropiane të Arsimit të lartë (HEAL). Duke ndërtuar mbi trashëgiminë tonë të pasur kulturore evropiane, ne po zhvillojmë një HEAL të bazuar në autonominë institucionale, lirinë akademike, mundësitë e barabarta dhe parimet demokratike që e lehtësojnë mobilitetin, e rrisin punësueshmërinë dhe e forcojnë atraktivitetin dhe aftësinë konkurruese të Evropës. Derisa shikojmë përpara, kuptojmë se do të na duhet që vazhdimisht t'i përshtatim sistemet tona të arsimit të lartë për të siguruar që HEAL do të mbetet konkurruese dhe e aftë që t'u përgjigjet në mënyrë efektive sfidave të globalizimit. Ne vlerësojmë se implementimi i reformave të Bolonjës është një detyrë e rëndësishme dhe e çojmë përkrahjen dhe përkushtimin e vazhdueshëm të të gjithë partnerëve në këtë proces. Ne mirëpresim kontributin dhe ndihmën e grupeve punuese në shtyrjen përpara të procesit. Ne pajtohemi të vazhdojmë të punojmë në partneritet, duke ndihmuar njëri tjetrin në promovimin e shkëmbimit të praktikave të mira.

1.4 Ne konfirmojmë përkushtimin tonë për rritjen e kompatibilitetit dhe krahasueshmërisë së sistemeve të arsimit të lartë, në të njëjtën kohë duke e respektuar edhe diversitetin e tyre. Ne e njohim dhe e pranojmë ndikimin e rëndësishëm të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në zhvillimin e shoqërive tona, duke u bazuar në traditën e tyre si qendra të nxënies, hulumtimit, kreativitetit dhe të transferit të dijes, si dhe rolin e tyre kyç në përcaktimin dhe bartjen e vlerave mbi të cilat ndërtohen shoqëritë tona. Ne synojmë të sigurojmë resurset e nevojshme që IAL-të tona të mund të vazhdojnë në plotësimin e tërë spektrit të misionit të vet. Ky mision përfshinë: përgatitjen e studentëve për jetë të qytetarëve aktiv në një shoqëri demokratike; përgatitja e studentëve për karrierën e tyre të ardhshme dhe duke mundësuar zhvillimin e tyre

personal; duke krijuar dhe kultivuar një bazë të gjerë dhe të avansuar të dijes; dhe duke stimuluar kërkimet shkencore dhe inovacionin.

1.5 Së këndejmi ne theksojmë rëndësinë e forcimit të institucioneve, të cilat janë të financuara si duhet, autonome, diverse dhe të përgjegjshme. Në tërë HEAL do të respektohen dhe promovohen parimet e mosdiskriminimit dhe të qasjes së barabartë. Ne zotohemi se do t'u përmbahemi këtyre parimeve dhe se nuk do të lejojmë kurrfarë diskriminimi as të personelit as të studentëve.

2. Përparimi në drejtim të HEAL

2.1 Raporti i jonë për përcjelljen e përparimit, së bashku me raportin Trendet V të AUE-së, raportin e ESIB-it Bolonja në sytë e studentëve dhe "*Fokusi në strukturën e arsimit të lartë në Evropë*" përgatitur nga Eurydice, konfirmojnë një përparim të mirë të gjithëmbarshtëm gjatë dy viteve të fundit. Tashmë ekziston një vetëdije e shtuar se ky proces do të rezultojë me një arsim të lartë me studentin në qendër dhe me shërbime që nuk do të kenë mësimdhënësit si pikë të vetme të orientimit. Ne do të vazhdojmë të përkrahim këtë proces të rëndësishëm.

Mobiliteti

2.2 Mobiliteti i personelit, i studentëve dhe i të diplomuarve është një ndër elementet thelbësore të Procesit të Bolonjës, pasi që krijon mundësi për zhvillim personal, për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në mes institucioneve dhe individëve, për avansimin e cilësisë së arsimit të lartë e të kërkimit shkencor dhe për realizimin e dimensionit evropian.

2.3 Ka pasur suksese që nga viti 1999, mirëpo mbetin edhe shumë sfida. Në këtë kuadër dallohen pengesat ndaj mobilitetit, çështjet përkitazi me imigrimin, njohja e dokumenteve, mungesa e stimulimeve financiare dhe skemat e papërshtatshme pensionale. Ne e pranojmë përgjegjësinë e qeverive individuale në lehtësimin e dhënies së vizave dhe të lejeve të punës e të qëndrimit. Ne zotohemi se do të punojmë me qeveritë tona për të shënuar përparim vendimtar në këtë fushë në rastet kur këto masa janë jashtë kompetencave tona. Në shkallë kombëtare do të angazhohemi për implementim të plotë të mekanizmave dhe procedurave të dakorduara të njohjes së dokumenteve dhe do të shqyrtojmë mundësitë për stimulimin e mëtejshëm të mobilitetit të personelit e të studentëve. Kjo përfshinë edhe inkurajimin e rritjes së konsiderueshme të numrit të programeve të përbashkëta dhe krijimin e kurrikulave fleksibile, si dhe nxitjen e institucioneve tona për të marrë më shumë përgjegjësi për mobilitetin e personelit e të studentëve dhe për më shumë baraspeshë në këtë kuptim ndërmjet vendeve të HEAL-it.

Struktura e thirrjeve

2.4 Tashmë është shënuar përparim i mirë në shkallë nacionale dhe institucionale drejtë realizimit të qëllimit tonë për një HEAL të bazuar në sistem prej tri ciklesh të studimeve. Numri i studentëve të regjistruar në dy ciklet e para është rritur dukshëm ndërkohë që janë hequr shumë barrierat strukturore në mes të cikleve. Ngjajshëm, është shtuar edhe numri i studimeve të strukturuar të doktoratës. Ne e theksojmë rëndësinë e reformimit të kurrikulave me qëllim të realizimit të kualifikimeve më të mira që u përshtaten më mirë si nevojave të tregut ashtu edhe për studime të mëtejme. Në të ardhmen duhet përqendruar

përpjekjet në drejtim të heqjes së pengesave për sigurim të qasjes, për përparim ndërmjet cikleve dhe për implementimin e duhur të ECTS-së të bazuar në rezultatet e nxënies dhe në ngarkesën e punës së studentit. Ne gjithashtu nënvizojmë rëndësinë e përmirësimit të punësueshmërisë së të diplomuarve, gjithnjë duke vërejtur se duhet të zhvillohet edhe më mbledhja e të dhënave lidhur me këtë çështje.

Njohja e diplomave

2.5 Njohja e drejtë e kualifikimeve të arsimit të lartë, të periudhave të studimit dhe të mësimit të mëparshëm, përfshirë edhe njohjen e mësimit joformal, janë komponente thelbësore të HEAL, si për së brendshmi ashtu edhe në kontekst global. Diploma dhe thirrje të lexueshme e të krahasueshme, si dhe informata të të bollshme në dispozicion për sistemet arsimore dhe për kornizat e kualifikimeve janë parakushte për mobilitetin e qytetarëve dhe për të siguruar aftësinë konkurruese dhe atraktivitetin e HEAL-it. Përderisa i gëzohemi faktit që 38 vende të Procesit të Bolonjës, përfshirë Malin e Zi, tashmë kanë ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës / UNESCO-s për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në rajonin e Evropës (Konventa e Lisabonës për Njohjen), ne i nxitim anëtarët e tjerë që ta bëjnë të njëjtën gjë me përparësi.

2.6 Është shënuar përparim në implementimin e Konventës së Lisabonës për Njohje (KLNJ), ECTS-së dhe të shtojcave të diplomës, mirëpo spektri i qasjeve institucionale dhe nacionale ndaj njohjes duhet të bëhet më koherent. Për përmirësimin e praktikave të njohjes kërkojmë nga Grupi për Përcjelljen e Bolonjës (GPB) të sigurojë që rrjetat ENIC/NARIC të analizojnë planet tona të veprimit dhe të ndikojnë në shpërndarjen e praktikave të mira.

Korniza e kualifikimeve

2.7 Kornizat e kualifikimeve janë instrumente të rëndësishme për realizimin e krahasueshmërisë dhe transparencës brenda HEAL-it dhe për lehtësimin e lëvizjes së studentëve për së brendi dhe ndërmjet sistemeve të ndryshme të arsimit. Ato gjithashtu i ndihmojnë IAL-të për zhvillimin e programeve studimore të bazuara në rezultatet e nxënies dhe në pikëkredita dhe ndihmojnë njohjen e kualifikimeve, si dhe të të gjitha formave të mësimit paraprak.

2.8 Ne kemi vërejtur se është bërë përparim fillestar drejtë realizimit të kornizave kombëtare të kualifikimeve, mirëpo duhen edhe përpjekje të tjera më të mëdha. Ne zotohemi për implementimin e plotë të kornizave të tilla kombëtare të kualifikimeve, të cilat verifikohen në krahasim me Kornizën e gjithëmbarshme të Kualifikimeve të HEAL, deri në vitin 2010. Të vetëdijshëm për ndërlikueshmërinë e kësaj detyre, kërkojmë nga Këshilli i Evropës të ndihmojë në shkëmbimin e përvojave në hartimin e kornizave kombëtare të kualifikimeve. Ne theksojmë se kornizat e kualifikimeve duhet të hartohen të tilla që të inkurajojnë mobilitet të shtuar të studentëve e të mësimsdhënësve dhe të përmirësojnë punësueshmërinë.

2.9 Ne na gëzon e dhëna që kornizat kombëtare të kualifikimeve të cilat janë kompatible me Kornizën e gjithëmbarshme të Kualifikimeve të HEAL-it do të jenë po ashtu në harmoni edhe me propozimin e Komisionit Evropian për Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për Arsimin Tërëjetësor.

2.10 Ne e konsiderojmë Kornizën e gjithëmbarshme të Kualifikimeve të HEAL-it,

për të cilën ishim pajtuar në Bergen, si element thelbësor të promovimit të arsimit të lartë evropian në kontekst global.

Mësimi Tërëjetësor

2.11 Raporti i përcjelljes së realizimit tregon se tashmë ekzistojnë disa elemente fleksibile të nxënies në shumicën e vendeve, mirëpo zhvillimi sistematik i shtigjeve fleksibile të nxënies, që do të ndihmonin mësimin tërëjetësor, është ende në fazë të hershme. Për këtë kërkojmë nga GPB-ja që të shtojë shkëmbimin e praktikave të mira dhe të punojë për kuptuarjen e drejtë të rolit të arsimit të lartë në mësimin tërëjetësor. Vetëm në një numër të vogël të vendeve të HEAL haset nivel i mirë i zhvillimit të njohjes së mësimin paraprak për qasje në arsimin e lartë dhe për fitimin e pikëkreditave. Ftojme GPB-në, që në bashkëpunim me ENIC/NARIC, të zhvillojë propozime për përmirësimin e njohjes së mësimin paraprak.

Sigurimi i Cilësisë dhe Regjistri Evropian i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë

2.12 Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në HEAL, e aprovuar në Bergen, kanë shërbyer si forcë e fuqishme shtytëse e ndryshimeve përkitazi me sigurimin e cilësisë. Të gjitha vendet kanë filluar t'i zbatojnë ato, përderisa disa kanë shënuar përparim të dukshëm në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, sigurimi i jashtëm i cilësisë është më i zhvilluar se më parë. Niveli i kyçjes së studentëve në të gjitha nivelet po ashtu është shtuar që nga viti 2005, megjithëse kërkohet edhe më shumë përmirësim. Pasi që përgjegjësia kryesore për sigurimin e cilësisë u takon IAL-ve, ato duhet të vazhdojnë zhvillimin e sistemeve të veta për sigurimin e cilësisë. Ne e pranojmë përparimin e arritur përkitazi me njohjen e ndërsjellë të vendimeve për akreditim dhe sigurim të cilësisë, dhe inkurajojmë bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet agjencive për sigurimin e cilësisë.

2.13 Forumi i parë Evropian për Sigurimin e Cilësisë, i organizuar bashkërisht nga AUE, ENQA, EURASHE dhe nga ESIB (Grupi E4) në vitin 2006 ka qenë një mundësi për diskutimin e zhvillimeve në sigurimin e cilësisë. Ne i inkurajojmë këto organizata që të organizojnë Forume vjetore Evropiane për Sigurimin e Cilësisë, për të lehtësuar shkëmbimin e praktikave të mira dhe për të siguruar vazhdimin e përmirësimit të cilësisë në HEAL.

2.14 Ne falënderojmë Grupin E4 Group për reagimin e tyre pozitiv ndaj kërkesës sonë për kryerjen e aspekteve praktike të themelimit të Regjistrimit të Agjencive Evropiane të Agjencive për Sigurimin e Cilësisë. Qëllimi i këtij regjistri është që t'u ofrojë të gjitha palëve të interesuara dhe opinionit publik qasje të plotë në informata objektive për agjencitë e besueshme për sigurimin e cilësisë që punojnë në harmoni me Udhëzimet dhe Standardet Evropiane (USE). Rrjedhimisht, kjo do të rris besimin në arsimin e lartë në HEAL dhe do të ndihmojë në njohjen e ndërsjellë të vendimeve për sigurimin e cilësisë dhe akreditimin. Ne mirëpresim themelimin e regjistrimit nga grupi E4, duke punuar në partneritet dhe duke u bazuar në modelin e propozuar të veprimit. Ky do të jetë një regjistër me bazë vullnetare, i vetë-financuar, i pavarur dhe transparent. Kërkesat për përfshirje në regjistër do të vlerësohen në bazë të përputhjes së tyre substanciale me USE, që do të konstatohet përmes një procesi të pavarur shqyrtues të mbështetur nga autoritetet nacionale, në rastet kur një mbështetje e tillë kërkohet nga ato autoritete. Kërkojmë nga grupi E4 të raportojë rregullisht lidhur me përparimin e shënuar nëpërmjet të GPB-së, dhe të sigurojë që

pas dy vitesh të punës së tij, do të ketë një vlerësim të jashtëm të regjistrit, gjithnjë duke marrë parasysh edhe pikëvështrimet e të gjitha palëve të interesuara.

Kandidatët për doktoraturë

2.15 Harmonizimi më i mirë i HEAL me Hapësirën Evropiane të Kërkimeve Shkencore (HEKSH) mbetet një objektiv i rëndësishëm. Ne e pranojmë rëndësinë e zhvillimit dhe ruajtjes së një spektri të gjerë e të llojlojshëm të programeve të doktoraturës të lidhura me kornizën e gjithëmbarshme të HEAL dhe, në të njëjtën kohë, duke iu shmangur kufizimeve të tepruara rregullative. Njëkohësisht, e kuptojmë se avansimi i shërbimeve të ciklit të tretë dhe përmirësimi i statusit në shoqëri, sigurimi i perspektivës dhe i mbështetjes financiare për puntorët shkencorë në fazën fillestare janë parakushte thelbësore për plotësimin e objektivave evropiane për avansimin e kapaciteteve kërkimore - shkencore dhe për përmirësimin e cilësisë e të aftësisë konkurruese të arsimit të lartë të Evropës.

2.16 Për këtë arsye i ftojme IAL-të tona që të shtojnë përpjekjet e veta për të përfshirë programet e doktoratës në politikat dhe strategjitë institucionale, si dhe të zhvillojnë shtigjet e duhura dhe mundësitë për zhvillim në karrierë për kandidatët për doktoratë dhe për puntorët e rinj shkencor.

2.17 Ftojme AUE-në të vazhdojë të përkrahë shkëmbimin e përvojave ndërmjet IAL-ve lidhur me spektrin e gjerë të programeve inovative të doktoratës që po paraqiten nëpër vendet e ndryshme të Evropës, si dhe për çështje të tjera thelbësore si dispozita transparente për sigurimin e qasjes, procedura për mbikqyrje dhe vlerësim, zhvillimin e shkathtësive të transferueshme dhe gjetjen e mënyrave për avansimin e punësueshmërisë. Ne do të angazhohemi për krijimin e mundësive të duhura për të inkurajuar shkëmbimin e shtuar të informatave për financimin dhe për çështje të tjera ndërmjet qeverive tona dhe me trupa të tjera për financimin e kërkimeve shkencore.

Dimensioni Social

2.18 Arsimit i lartë duhet të luaj rol të fuqishëm në kultivimin e kohezionit social, në uljen e pabarazive dhe në ngritjen e nivelit të dijeve, të shkathtësive e të kompetencave në shoqëri. Së këndejmi, politikat duhet të synojnë rritjen e potencialit të individëve për zhvillimin e tyre personal dhe për të shtuar kontributin e tyre për një shoqëri të qëndrueshme demokratike e të bazuar në dije. Ne besojmë se popullata studentore duhet të reflektojë diversitetin e popullatës së vendeve tona. Ne i japim rëndësinë e duhur faktit që studentët duhet të jenë në gjendje të mbarojnë studimet e veta pa pengesa që do të buronin nga statusi i tyre social e ekonomik. Për këtë ne vazhdojmë angazhimin tonë për sigurimin e shërbimeve të duhura për studentët, për krijimin e shtigjeve më fleksibile të nxënies për pranim dhe studim në arsimin e lartë, si dhe të zgjerohet pjesëmarrja në të gjitha nivelet në bazë të mundësive të barabarta.

Hapësira Evropiane e Arsimit të lartë në kontekst global

2.19 Ne gëzojemi që reformat e Bolonjës kanë nxitur interesim të konsiderueshëm në shumë pjesë të botës, duke stimuluar diskutime ndërmjet evropianëve dhe partnerëve ndërkombëtarë lidhur me një sërë temash. Këtu përfshihen njohja e kualifikimeve, përfitimet nga bashkëpunimi i bazuar në partneritet, mirëkuptim dhe besim i ndërsjellë, si

dhe vlerat e tjera bazë të Procesit të Bolonjës. Për më tepër, ne jemi dëshmitarë se në disa vende në pjesë të tjera të botës ka përpjekje për të harmonizuar sistemet e tyre të arsimit të lartë me kornizën e Bolonjës.

2.20 Ne e miratojmë strategjinë "Hapësira Evropiane e Arsimit të lartë në kontekst global" dhe do të çojmë përpara punën në këto fusha themelore: përmirësimi i informimit për HEAL dhe promovimi i atraktivitetit dhe i aftësisë së saj konkurruese; forcimi i bashkëpunimit të bazuar në partneritet; intensifikimi i dialogut mbi politikat; dhe përmirësimi i njohjes [së diplomave]. Kjo punë duhet parë në korelacion me *Udhëzimet e OECD/UNESCO-s për Ofrimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë përtej Kufijve*

3. Prioritetet deri në vitin 2009

3.1 Gjatë dy viteve të ardhshme, pajtohemi të përqendrohemi në përfundimin e Vijave të Veprimit, përfshirë prioritetet në vazhdim për sistemin e studimeve në tri cikle, sigurimin e cilësisë dhe njohjen e diplomave e të periudhave të studimit. Ne do të përqendrohemi sidomos në këto fusha të të veprimit.

Mobiliteti

3.2 Në raportet tona për vitin 2009, ne do të raportojmë për veprimet e ndërmarra në shkallë kombëtare për promovimin e mobilitetit të studentëve e të personelit, përfshirë edhe masat për vlerësim të ardhshëm. Ne do të përqendrohemi në sfidat kryesore në shkallë kombëtare të identifikuar më lartë në paragrafin 2.3. Gjithashtu pajtohemi që të ngrisim një rrjetë të ekspertëve në shkallë kombëtare për shkëmbimin e informatave, dhe për të ndihmuar në identifikimin dhe tejkalimin e pengesave për bartjen e granteve e kredive.

Dimensioni Social

3.3 Ngjashëm, do të raportojmë për strategjitë dhe politikat tona kombëtare për dimensionin social, përfshirë planet e veprimit dhe masat për vlerësimin e efektivitetit të tyre. Ne do të ftojme të gjitha palët e involvuara që të marrin pjesë dhe të përkrahin këto angazhime në shkallë kombëtare.

Mbledhja e të dhënave

3.4 Ne pajtohemi për nevojën e përmirësimit të qasjes në të dhënat për mobilitetin edhe për dimensionin social në të gjitha vendet pjesëmarrëse në Procesin e Bolonjës. Për këtë kërkojmë nga Komisioni Evropian (Eurostat), që në bashkëpunim me Eurostudent-in, të zhvillojë të dhëna dhe tregues të krahasueshëm e të besueshëm për të bërë matjen e progresit drejt realizimit të objektivit të gjithëmbarshtëm për dimensionin social dhe për mobilitetin e studentëve e të personelit në të gjitha vendet e Bolonjës. Të dhënat në këtë fushë duhet të përfshijnë edhe pjesëmarrjen e barabartë në arsimin e lartë si dhe punësueshmërinë e të diplomuarve. Kjo detyrë duhet të kryhet në bashkëpunim me GPB-në dhe një raport të dorëzohet për konferencën tonë ministrore të vitit 2009.

Punësueshmëria

3.5 Duke u nisur nga zbatimi i sistemit të studimeve në tri cikle, kërkojmë nga GPB-ja

që të shqyrtojë më në hollësi mundësinë e përmirësimit të punësueshmërisë në raport me secilin nga këto tri cikle, si dhe në kontekst të mësimi tërëjetësor. Kjo do të përfshijë përgjegjësitë e të gjitha palëve të involvuara. Qeveritë dhe IAL-të do të duhet të komunikojnë më shumë me punëdhënësit dhe me palët e tjera të involvuara lidhur me arsyeshmërinë e reformave të veta. Ne do të punojmë brenda qeverive tona për të siguruar që strukturat për punësim dhe për karrierë në administratën tonë publike të jenë në harmoni të plotë me sistemin e ri të thirrjeve. Ne i nxisim institucionet që ta zhvillojnë më tej partneritetin dhe bashkëpunimin me punëdhënësit në një proces të vazhdueshëm të rishkrimit të kurrikulave të bazuara në rezultatet e nxënies.

Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë në kontekst global

3.6 Kërkojmë nga GPB-ja që, deri në vitin 2009, të na raportojë për zhvillimet e gjithëmbarshme në këtë fushë në shkallë evropiane, kombëtare dhe institucionale. Të gjitha palët e involvuara luajnë rol të rëndësishëm në sferën e tyre të përgjegjësisë. Gjatë raportimit për implementimin e strategjisë për HEAL në kontekstin global, GPB-ja duhet të ketë para sysh sidomos dy përparësi: së pari, të përmirësojë informatat në dispozicion lidhur me HEAL, duke e zhvilluar web-faqen e Sekretariatit të Bolonjës dhe duke u bazuar në doracakun e AUE-së për Bolonjën; dhe, së dyti, të përmirësojë njohjen. U bëjmë thirrje IAL-ve, qendrave të ENIC/NARIC-ut dhe autoriteteve të tjera për njohje në kuadër të HEAL që të vlerësojnë kualifikimet nga pjesë të tjera të botës me të njëjtën haptësi me të cilën do të donin që të vlerësoheshin kualifikimet evropiane gjatë në botë, dhe ta bazojnë këtë njohje në KLNJ.

Përcjellja e Procesit

3.7 Kërkojmë nga GPB-ja të vazhdojë me Përcjelljen e Procesit, duke u bazuar në raportet kombëtare që do të arrijnë për konferencën tonë ministrore të vitit 2009. Presim zhvillime të mëtejme të analizave cilësore të procesit të përcjelljes, veçanërisht sa i përket mobilitetit, Procesit të Bolonjës në kontekstin global dhe dimensionit social. Fushat e mbuluara nga procesi i përcjelljes duhet të vazhdojnë të përfshijnë sistemin e studimeve dhe punësueshmërinë e të diplomuarve, njohjen e diplomave e të periudhave të studimeve dhe implementimin e të gjitha aspekteve të sigurimit të cilësisë në përputhje me USE. Gjithnjë duke pasur parasysh zhvillimin e nxënies me studentin në qendër dhe duke u bazuar në rezultate të nxënies, faza e ardhshme duhet të merret në mënyrë të integruar edhe me kornizat kombëtare të kualifikimeve, rezultatet e nxënies dhe pikëkreditat, mësimin tërëjetësor dhe njohjen e mësimi paraprak.

4. Një shikim në vitin 2010 e përtej

4.1 Për atë që HEAL do të vazhdojë të zhvillohet dhe t'u përgjigjet sfidave të globalizimit, për atë që parashohim se do të ketë nevojë të vazhdohet edhe me bashkëpunimin.

4.2 Ne jemi të vendosur që të shkojmë më tutje me themelimin e HEAL në vitin 2010, i cili do të shënojë kalimin prej Procesit të Bolonjës në HEAL, si një mundësi për të vërtetuar përkushtimin tonë ndaj arsimit të lartë si element kyç për t'i bërë shoqëritë tona të qëndrueshme, si në plan kombëtar dhe në atë evropian. Ne do ta marrim vitin 2010 si një mundësi për riformulimin e vizionit që na ka motivuar për të vënë në lëvizje Procesin e Bolonjës në vitin 1999 dhe të vendosim themelet për një HEAL të ngritur mbi vlera dhe

vizione që shkojnë përtej strukturave dhe instrumenteve. Ne zotohemi ta bëjmë vitin 2010 një mundësi për të rivendosur sistemet tona të arsimit të lartë në një rrugë që shikon matanë çështjeve ditore dhe që i bën ato të përshtatshme që ballafaqohen me sfidat që do të përcaktojnë të ardhmen tonë.

4.3 Kërkojmë nga GPB-ja si tërësi që të shikojë se si do të mund të zhvillohet HEAL-i pas vitit 2010 dhe të raportojë për këtë në takimin e ardhshëm të ministrave të vitit 2009. Kjo duhet të përfshijë propozime për struktura përkatëse për mbështetjen e procesit, duke pasur parasysh se skemat e tanishme joformale të bashkëpunimit po funksionojnë mirë dhe kanë sjellur deri te ndryshime të papara.

4.4 Duke u nisur nga praktika të mëparshme të përcjelljes së procesit, *Trends-i*, dhe nga *Bologna në sytëe studentëve*, ftojme GPB-në të mendojë për përgatitjen e një raporti që do të përfshinte një vlerësim të pavarur, në parnteritet me anëtarët konsultativ, ku do të vlerësohej përparimi i gjithëmbarshtëm i Procesit të Bolonjës në tërë HEAL që nga viti 1999.

4.5 Vendimi për natyrën, përmbajtjen dhe vendin e çfarëdo Takimi Ministror në vitin 2010 i mbetet GPB-së dhe pritet të merret brenda pjesës së parë të vitit 2008

4.6 Takimi ynë i radhës do të organizohet nga vendet e Beneluksit në Leuven/Louvain-la-Neuve më 28-29 prill 2009